9. Një TCR siç pretendohet në ndonjërin pretendim të mëparshëm, i cili është një heterodimer alfa-beta, që ka një sekuencë të domenit konstant TRAC të vargut alfa dhe një sekuencë të domenit konstant TRBC1 ose TRBC2 të vargut beta, opsionalisht ku sekuencat e domenit konstant të vargut alfa dhe beta janë modifikuar nga shkurtimi ose zëvendësimi për të fshirë një lidhje disulfide natyrale mes Cys4 të ekzonit 2 të TRAC dhe Cys2 të ekzonit 2 të TRBC1 ose TRBC2, më tej opsionalisht ku sekuenca(t) e domenit konstant të vargut alfa dhe/ose beta janë modifikuar nga zëvendësimi i mbetjeve të cisteinës për Thr 48 të TRAC dhe Ser 57 të TRBC1 ose TRBC2, cisteinat e sipërpërmendura që formojnë një lidhje disulfide jo-natyrale mes domeneve konstante alfa dhe beta të TCR.

10. Një TCR siç pretendohet në ndonjërin pretendim të mëparshëm, i cili është në format vargu të vetëm të tipit $V\alpha$ -L- $V\beta$, $V\beta$ -L- $V\alpha$, $V\alpha$ - $C\alpha$ -L- $V\beta$, $V\alpha$ -L- $V\beta$ - $C\beta$, ku $V\alpha$ dhe $V\beta$ janë rajone të ndryshueshme TCR α dhe β respektivisht, $C\alpha$ dhe $C\beta$ janë rajone konstante TCR α dhe β respektivisht, dhe L është një sekuencë lidhëse.

11. Një TCR siç pretendohet në ndonjërin pretendim të mëparshëm e lidhur me një etiketim të dallueshëm, një agjent terapeutik ose një pjesë modifikuese PK, opsionalisht ku një

antitrop anti-CD3 është lidhur në mënyrë kovalente te C- ose N-fundor i vargut alfa ose beta të TCR, opsionalisht nëpërmjet një sekuence lidhëse e cila është opsionalisht e zgjedhur nga grupi i përbërë prej GGGGS (SEQ ID NO: 31), GGGSG (SEQ ID NO: 32), GGSGG (SEQ ID NO: 33), GSGGG (SEQ ID NO: 34), GSGGGP (SEQ ID NO: 35), GGEPS (SEQ ID NO: 36), GGEGGGP (SEQ ID NO: 37), dhe GGEGGGSEGGGS (SEQ ID NO: 38).

12. Një molekulë bashkimi TCR-anti-CD3 ku domeni i ndryshueshëm i vargut alfa përfshin një sekuencë amino acide të zgjedhur nga SEQ ID NOs: 6-8 dhe domeni i ndryshueshëm i vargut beta përfshin një sekuencë amino acide të zgjedhur nga SEQ ID NOs: 9-24, dhe ku antitropi anti-CD3 është lidhur në mënyrë kovalente te N-fundor ose C-fundor i vargut beta TCR nëpërmjet një sekuence lidhëse zgjedhur nga SEQ ID NOs: 31-38.

13. Një molekulë bashkimi TCR-anti-CD3 sipas pretendimit 12, ku molekula e bashkimit TCR-anti-CD3 përfshin

një sekuencë amino acide të vargut alfa të zgjedhur nga SEQ ID NOs: 25, 27 ose 29 ose një sekuencë amino acide të vargut alfa që ka të paktën 90% identitet, të tillë si 90%, 91%, 92%, 93%, 94%, 95%, 96%, 97%, 98%, 99% ose 100% identitet, me sekuencat amino acide siç përcaktohen në SEQ ID NOs: 25, 27 dhe 29

dhe një sekuencë amino acide të vargut beta të zgjedhur nga SEQ ID NOs: 26, 28 dhe 30 ose një sekuencë amino acide të vargut beta që ka të paktën 90% identitet, të tillë si 90%, 91%, 92%, 93%, 94%, 95%, 96%, 97%, 98%, 99% ose 100% identitet, me sekuencat amino acide siç përcaktohen në SEQ ID NOs: 26, 28 dhe 29.

14. Molekula e bashkimit TCR-anti-CD3 sipas pretendimit 12 ku molekula e bashkimit TCR-anti-CD3 përfshin një sekuencë amino acide të vargut alfa që korrespondon me SEQ ID NO: 25 dhe sekuencë amino acide të vargut beta që korrespondon me SEQ ID NO: 26.

15. Molekula e bashkimit TCR-anti-CD3 sipas pretendimit 12 ku molekula e bashkimit TCR-anti-CD3 përfshin një sekuencë amino acide të vargut alfa që korrespondon me SEQ ID NO: 27 dhe sekuencë amino acide të vargut beta që korrespondon me SEQ ID NO: 28.

16. Molekula e bashkimit TCR-anti-CD3 sipas pretendimit 12 ku molekula e bashkimit TCR-anti-CD3 përfshin një sekuencë amino acide të vargut alfa që korrespondon me SEQ ID NO: 29 dhe sekuencë amino acide të vargut beta që korrespondon me SEQ ID NO: 30.

17. Një acid nukleik që kodon një varg alfa TCR = dhe/ose një varg beta TCR siç pretendohet në çdo njërin prej pretendimeve të mëparshme.

18. Një vektor shprehës që përfshin acidin nukleik të pretendimit 17.

19. Një qelizë që strehon

(a) një vektor shprehës siç pretendohet në pretendimin 18 që kodon vargjet TCR alfa dhe beta siç pretendohet në çdo njërin prej pretendimeve 1 deri në 11, në një kornizë të vetme leximi të hapur, ose dy korniza leximi të hapura të dallueshme; ose

(b) një vektor shprehës të parë i cili përfshin acidin nukleik që kodon vargun alfa të një TCR siç pretendohet në çdo njërin prej pretendimeve 1 deri në 11, dhe vektor shprehës të dytë i cili përfshin acidin nukleik që kodon vargun beta të një TCR siç pretendohet në çdo njërin prej pretendimeve 1 deri në 11.

20. Një qelizë që nuk ndodh në mënyrë natyrale dhe/ose e pastruar dhe/ose e inxhinieruar, veçanërisht një qelizë T, që prezanton një TCR siç pretendohet në çdo njërin prej pretendimeve 1 deri në 10.

21. Një kompozim farmaceutik që përfshin një TCR siç pretendohet në çdo njërin prej

pretendimeve 1-11, ose një molekulë bashkimi TCR-anti CD3 siç pretendohet në çdo njërin prej pretendimeve 12 deri në 16, ose një qelizë siç pretendohet në pretendimin 19 ose 20, bashkë me një ose më shumë mbartës ose eksipientë farmaceutikisht të pranueshëm.

22. TCR e çdo njërit prej pretendimeve 1 deri në 11, ose molekula e bashkimit TCR-anti-CD3 sipas çdo njërit prej pretendimeve 12 deri në 16, ose acidi nukleik i pretendimit 17, ose kompozimi farmaceutik i pretendimit 21 ose qeliza e pretendimit 19 ose 20, për përdorim në mjekësi, në mënyrë të preferuar në një subjekt human.

23. TCR e çdo njërit prej pretendimeve 1 deri në 11, ose molekula e bashkimit TCR-anti-CD3 sipas çdo njërit prej pretendimeve 12 deri në 16, ose acidi nukleik i pretendimit 17, ose kompozimi farmaceutik i pretendimit 21 ose qeliza e pretendimit 19 ose 20, për përdorim në një metodë të trajtimit të kancerit ose një tumori, në mënyrë të preferuar në një subjekt human, opsionalisht ku

subjekti human ka një tumor që shpreh PRAME,

tumori është një tumor i ngurtë,

subjekti human është i nëntipit HLA-A*02, dhe/ose

TCR, molekula e bashkimit TCR-anti-CD3, acidi nukleik, kompozimi farmaceutik ose qeliza është administruar me anë të injektimit, të tillë si intravenoz ose injektim direkt intratumoral.

24. Një formulim i injektueshëm për administrim të një subjekti human që përfshin një TCR sipas çdo njërit prej pretendimeve 1 deri në 11 ose një molekulë bashkimi TCR-anti-CD3 sipas çdo njërit prej pretendimeve 12 deri në 16.

25. Një metodë për prodhimin e një TCR sipas çdo njërit prej pretendimeve 1 deri në 11, ose një molekulë bashkimi TCR-anti-CD3 sipas çdo njërit prej pretendimeve 12 deri në 16, që përfshin a) mbajtjen e një qelize sipas pretendimit 19 në kushte optimale për shprehjen e vargjeve TCR dhe b) izolimin e vargjeve TCR.

(11) **11547**

(97) EP3806687/ 15.02.2023

(96) 19739393.7/ 12.06.2019

(22) 14.04.2023

(21) AL/P/2023/154

(54) **METODË DHE APARAT PËR MONTIMIN E NJË ARTIKULLI LËKURE TË TILLË SI NJË KËPUCË**

17.08.2023

(30) 201800006292

(71) Gucci Logistica S.p.A.

Via Don Lorenzo Perosi 6

(72) BACHECHI, Matteo;GOTTARDINI, Massimo;NANNINI, Marco, Via Francesco De Sanctis, 6;Via Palmiro Togliatti, 66/A;Viale della Repubblica, 134

(74) Ela SHOMO PANIDHA

Euromarkpat Albania SH.P.K , Rr. A.Z. Çajupi, Pall. 20/4, Ap.15, Tiranë

(57) 1. Një aparat për të montuar një artikull lëkure të tillë si një këpucë, ku aparati përmban një njësi montuese (2) të përshtatur për të pritur një ose më shumë komponente të artikullit të përmendur, mjete të përfuturit video të përshtatura për të fotografuar njësine

montuese të përmendur (2) dhe të sigurojë të paktën një imazh të përfutur (P) të komponentente të artikullit të përmendur, të paktën një ekran shfaqës (4) të përshtatur për të shfaqur të përmendurin të paktën një imazh (P) të përfutur nga mjetet e përfutimit video të përmendura; mjete projektioni të përshtatura për të projektuar në artikullin e përmendur në njësinë montuese të përmendur një ose më shumë shenja referuese ndriçuese (Mp); një njësi kontrolli elektronike (5) operativisht të lidhur për shkëmbim të dhënash dhe/ose sinjali me mjetet e përfutimit video të përmendur, ekranin e përmendur dhe ekranin projektues të përmendur, ku ekrani i përmendur (4) është përshtatur të lejojë një punonjës stafi të prezantojë grafikisht, në mbivendosje tek imazhi i përfutur i përmendur (P), një model referues (Mm) që përmban gjeometri referuese të montimit; dhe ku njësia e kontrollit e përmendur (5) është konfiguruar të ngarkojë dhe të ruajë modelin referues të përmendur (Mm), për të përpunuar dhe siguruar instruksione kontrolli tek mjetet projektuese të përmendura mbi bazën e modelit referues të përmendur (Mm), ku instruksionet e përmendura janë përshtatur për të mundësuar që mjetet projektuese të përmendura të projektohen në shenjat referuese ndriçuese të komponenteve të artikullit të përmendur (Mp) në përputhje me modelin referues të përmendur (Mm), për ta ndihmuar punonjësin e stafit në hapat e montimit.

2 Aparati sipas pretendimit 1, ku ekrani i përmendur është një ekran shfaqës me prekje.

3 Aparati sipas pretendimit 1 ose 2, ku njësia kontrolluese e përmendur (5) është konfiguruar të ruajë një librari të modeleve referuese të përmendura (Mm) secili i shoqëruar me një model artikulli dhe/ose një imazh relativ (P), dhe të rigjejë nga libraria e ruajtur e përmendur një model referues (Mm) që të angazhohet për të prodhuar instruksionet e përmendura.

4 Aparati sipas secilit prej pretendimeve të mëparshme, ku mjetet projektuese të mëparshme përmbajnë një ose më shumë pasqyra (311, 312) të shtyrë në rrotullim në një mënyrë të kontrolluar nga galvanometrat përkatës (313, 314) për të devijuar dhe zhvendosur në një drejtim të synuar të dëshiruar një rreze drite koherente (Fs) të lëshuar nga një burim drite.

5 Aparati sipas pretendimit 4, ku mjetet projektuese të përmendura përmbajnë dy pasqyra të pjerrëta që anojnë rreth boshteve përkatëse reciprokisht ortogonale, që të drejtojnë zhvendosjen e rrezes së përmendur (Fs) përkatësisht në një koordinatë X dhe në një koordinatë Y të një sistemi referues Kartezian.

6 Aparati sipas pretendimit 5, ku instruksionet e përmendura janë në formën e një skedari konfigurues i përshtatur të drejtojë galvanometrat e përmendur për të lëvizur rrezën e përmendur në koordinatat XY.

7 Aparati sipas secilit prej pretendimeve të mëparshme, ku njësia kontrolluese e përmendur (5) është drejtpërsëdrejti ose tërthorazi në komunikim menjë rrjet të dhënash lokal ose botëror, nëpërmjet një linje shkëmbimi të dhënash (42) me tel ose pa tel.

8 Një metodë për të montuar një grumbull artikujsh lëkure të tillë si këpucë në një aparat montues sipas secilit prej pretendimeve nga 1 deri në 7, ku metoda përmban hapat e: pozicionimit të komponenteve të një artikulli të parë të grumbullit të përmendur në njësinë montuese të përmendur (2); fotografimit të komponenteve të përmendura me mjetet e përfuturit video të përmendura; shfaqjen e të paktën një imazhi (P) të artikullit të përfutur eksisoj në ekranin shfaqës të përmendur (4); paraqitjes grafike në ekranin e përmendur, në mbivendosje tek imazhi i përfutur (P) i përmendur dhe nga një punonjës stafi, të një modeli referues (Mm) që përmban gjeometri referuese të montimit; ngarkimit dhe ruajtjes të modelit referues (Mm) të përmendur në njësinë kontrolluese elektronike (5); në bazën e modelit referues (Mm) të përmendur, njësinë kontrolluese e përmendur (5) përpunon dhe ofron instruksione kontrolli tek mjetet projektuese të përmendura, ku sipas këtyre instruksioneve shenjat referuese ndriçuese (Mp) projektohen në komponentet e artikullit të përmendur në përputhje me modelin referues (Mm) të përmendur; kryerjes së hapit montues të përmendur me ndërhyrjen ose mbikqyrjen nga punonjësi i stafit, i ndihmuar nga she-njat referuese ndriçuese të përmendura; nxjerrjes së artikullit të parë të përmendur nga njësinë montuese e përmendur; pozicionimit në sekuencë të komponenteve të një ose më shumë artikujve të të njëjtit grumbull, dhe kryerjen mbi ta të hapave montues përkatës mbi bazën e modelit referues (Mm) të ruajtur të njëjtë.

9 Metoda sipas pretendimit 8, ku modeli referues (Mm) i përmendur prodhohet nëpërmjet tërheqjes me dorë mbi një ekran me prekje.

10 Metoda sipas pretendimit 8 ose 9, ku modeli referues (Mm) i përmendur përmban një ose më shumë gjeometri vektoriale që përmbajnë pika, vija të drejta, vija të lakuara, vija poligonale ose një kombinim i elementeve të tilla.

11. Metoda sipas secilit prej pretendimeve nga 8 në 10, ku hapi montues i përmendur përmban verifikimin nga punonjësi i përmendur, të përafritimit të kontureve të artikullit që është montuar dhe shenjave ndriçuese (Mp) të projektuara të përmendura.

12 Metoda sipas secilit prej pretendimeve nga 8 deri në 11, ku instruksionet e kontrollit të përmendura përfutrohen nga një model referues i rifutur nga një ose më shumë modele referuese të ruajtura të grumbujve të montuar më parë.

13

Metoda sipas secilit prej pretendimeve nga 8 deri në 12, ku në fazën montuese të përmendur punonjësi i përmendur aktivizohet të kryejë një ose më shumë nga veprimet vijuese:

prodhimin e shenjave referuese ndriçuese për tu projektuar në një pozicion specifik tek artikulli pavarësisht nga, ose si shtesë ndaj, shenjave ndriçuese të projektuara të përmendura (Mp) në përputhje me modelin referues; korrigjimin në pozicionin e secilës shenjë referuese ndriçuese të projektuar.

14 Metoda sipas secilit prej pretendimeve nga 8 deri në 13, përmban një hap ruajtës të imazhit të përfutur (P) të artikullit, preferueshëm në lidhje me një model referues (Mm) relativ.

15 Metoda sipas secilit prej pretendimeve nga 8 deri në 14, ku modele vektoriale të veçanta krijohen nëpërmjet matricave kalibruese dhe projektohen të ndohmojnë punën e elementeve të veçanta të artikullit.

(11) **11550**

(97) EP3967471/ 19.04.2023

(96) 21191232.4/ 13.08.2021

(22) 28.04.2023

(21) AL/P/2023/156

(54) **KIT PËR DERDHJEN E ARTIKUJVE TË PRODHUAR NGA POLIMERI**

18.08.2023

(30) 202000021727

(71) DA. MA. & Co S.r.l.

Via del Castello, 9

(72) MAZZA, Dario;MAZZA, Emanuele,

(74) Ela SHOMO PANIDHA

Euromarkpat Albania SH.P.K., Rr. A.Z. Çajupi, Pall. 20/4, Ap.15, Tiranë

(57) 1. Një kit për derdhjen e artikujve të prodhuar nga polimeri, i tipit që përmban një pjesë kallëpi mashkull (2), i pajisur me të paktën një vatër të parë (3, 4) që përputhet me të paktën një porcion të parë (5) të të paktën një artikulli të prodhuar (6a, 6b) që do të sigurohet, dhe një pjesë kallëpi femër (7), të pajisur me të paktën një vatër të dytë (8, 9) që përputhet tek të paktën një porcion i dytë (10), i cili është plotësues tek i përmenduri të paktën një porcion i parë (5) i të paktën një artikulli të prodhuar (6a, 6b) që do të sigurohet, ku:

- të paktën një komponent i përzgjedhur nga pjesa kallëp mashkull e përmendur (2), pjesa kallëp femër e përmendur (7) dhe të paktën një pllakë ndihmëse të ndërmjetme (11) përmban një bordurë perimetrike ndërfitëse (12, 13) e cila kufizohet nga sipërfaqe kryesisht të sheshta dhe të rregullta, ku bordura perimetrike ndërfitëse e përmendur (12, 13) përmban një vrimë mespërme (16, 17) e cila të çon tek një brazdë (18, 19) e faqes së brendshme të komponentit të përmendur, ku brazda e përmendur (18, 19) bashkon vrimën mespërme të përmendur (16, 17) me vatrën përkatëse (3, 4, 3a, 4a) të komponentit të përmendur; dhe

- të paktën një komponent shtesë i përzgjedhur nga pjesa kallëp femër e përmendur (7), pjesa kallëp mashkull e përmendur (2) dhe të paktën një pllakë ndihmëse e ndërmjetme (11) përmban një dhëmbëzim perimetrik të zhytur (14, 15), të kufizuar nga sipërfaqe kryesisht të sheshta dhe të rregullta, ku dhëmbëzimi perimetrik i përmendur (14, 15) ka një formë dhe dimensione të cilat janë plotësuese me ato të bordurës perimetrike ndërfitëse të përmendur (12, 13) për një çiftim hermetik përkatës kur pjesa kallëp mashkull e përmendur (2) dhe pjesa kallëp femër e përmendur (7) çiftohen reciprokisht në mënyrë të tillë që të përcaktojnë kavitetin që përputhet me artikullin e prodhuar (6a, 6b) që do të sigurohet i karakterizuar në atë që i përmenduri të paktën një komponent shtesë përmban një brazdë plotësuese (20) me formë dhe dimensione plotësuese

me ato të brazdës së përmendur (18, 19), kur pjesa kallëp mashkull e përmendur (2) dhe pjesa kallëp femër e përmendur (7) çiftohen reciprokisht në mënyrë të tillë që të përcaktojnë kavitetin që përputhet me artikullin e prodhuar (6a, 6b) që do të sigurohet; vrima e përmendur (16), brazda e përmendur (18) dhe brazda plotësuese e përmendur (20) përcaktojnë kanalin për injektimin e polimerit në kavitetin e përmendur.

2. Kiti sipas pretendimit 1, i karakterizuar në atë që e përmendura të paktën një pllakë ndihmëse e ndërmjetme (11) përmban, në një pamje të parë të saj, një shirit perimetrik ndërfutës, dmth., një bordurë (13), me formë dhe dimenisone plotësuese me ato të dhëmbëzimit të përmendur (14) për një çiftim hermetik përkatës në konfigurimin e ballafaqimit reciprok, dhe, në një pamje të dytë, një zgavër perimetrike e zhytur, dmth., një dhëmbëzim (15), me formë dhe dimensione plotësuese me ato të bordurës së përmendur (12) për një çiftim hermetik përkatës në konfigurimin e ballafaqimit reciprok.
3. Kiti sipas pretendimit 1, i karakterizuar në atë që komponentet e përmendur, gjatë veprimtarive të derdhjes, mbahen në një temperaturë të përfshirë ndërmjet 100°C dhe 250°C.
4. Kiti sipas pretendimit 1, i karakterizuar në atë që një zonë (16a, 17a) e sipërfaqes së jashtme të bordurës perimetrike ndërfutëse të përmendur (12, 13) e cila përmban vrimën mespërme të përmendur (16, 17) e cila të çon tek brazda e përmendur (18, 19) e faqes së brendshme të komponentit përkatës ka një formë kryesisht plotësuese me atë të një pipëze për injektimin e një polimeri të nxehtë, ku pipa e përmendur pozicionohet përballë zonës së përmendur (16a, 17a) të sipërfaqes së jashtme të përmendur gjatë injektimit të polimerit të përmendur.

(11) **11551**

(97) EP3836024/ 25.01.2023

(96) 20213520.8/ 11.12.2020

(22) 20.04.2023

(21) AL/P/2023/157

(54) **NJËSI FILTRI PËR NJË PRODUKT TYMUES DUHANI DHE DISPONUES I NJË NJËSIE TË PËRDORUR FILTRI**

18.08.2023

(30) 102019134196

(71) Mayr-Melnhof Karton AG

Brahmsplatz 6

(72) THEIS, Uwe; VORENKAMP, Harman, Langensteinstrasse 11; Mörikestrasse 6/2

(74) Krenar LOLOÇI

Rr. Ibrahim Rugova, P.1/1, Kati II, Tiranë, Shqipëri

(57)

1. Një pajisje për disponimin e një njësie të përdorur filtri (4) të një produkti tymues duhani (1), pajisje (8) që përmban

- një hapësirë (9) për marrjen e njësive së filtrit (4),
- një lexues (11), që konfigurohet të lexojë automatikisht një identifikues të njësive së filtrit (4) nga një përcjellës të dhënash (7) të njësive së filtrit (4) kur njësia e filtrit (4) futet në hapësirën (9);
- një njësi komunikuese (12, 13), e cila konfigurohet

- të krahasojë identifikuesin e lexueshëm me një kod reference, që depozitohet në një bazë të dhënash (15);
- të gjenrojë të paktën një sinjal elektrik në varësi të një rezultati krahasimi; që karakterizohet nga

- një njësi procesues filtri (16), që konfigurohet të shkatërrojë njësienë e filtrit (4) në varësi të rezultatit të krahasimit.

2. Pajisje sipas pretendimit 1, ku njësia e komunikimit (12, 13) konfigurohet të modifikojë kodin e referencës në varësi të paktën të një sinjali elektrik nëse kodi i referencës i korrespondon identifikuesit të lexueshëm.

3. Një metodë për disponimin e një njësie të përdorur filtri (4) të një produkti tymues duhani (1), ku

- njësia e filtrit (4) përmban një përcjellës të dhënash (7), ku identifikuesi i njësive së filtrit (4) depozitohet në përcjellësin e të dhënave (7);
- identifikuesi i njësive së filtrit (4) është i lexueshëm nga makina;
- identifikuesi i lexueshëm krahasohet me një kod reference, që depozitohet në një bazë të dhënash (15), me anën e një njësie komunikimi (12, 13);
- të paktën një sinjal elektrik gjenerohet në varësi të një rezultati krahasimi; dhe
- njësia e filtrit (4) shkatërrohet në varësi të rezultatit të krahasimit.

4. Metodë sipas pretendimit 3, ku përcjellësi i të dhënave (7) përmban një fill të shkruajtshme në mënyrë magnetike (7a).

5. Metodë sipas pretendimit 4, ku

- njësia e filtrit (4) përmban një material filtri (6) dhe filli e shkruajtshëm (7a) gjendet i ngulitur në materialin e filtrit (6), ose
- njësia e filtrit (4) përmban një pjesë goje (5), që përmban fillin e shkruajtshëm (7a).

6. Metodë sipas pretendimit 3, ku përcjellësi i të dhënave (7) përfshin një marrës RFID.

7. Metodë sipas secilit prej pretendimeve 3 ose 6, ku njësia e filtrit (4) përmban një kapsulë (7b), që përmban përcjellësin e të dhënave (7).

8. Metodë sipas pretendimit 3, ku

- njësia e fltrit (4) përmban një pjesë goje (5); dhe
- përcjellësi i të dhënave (7) përmban një ngjyruar të magnetizuar (7c), i cili i bashkëngjitet pjesës së gojës (5).

(11) **11542**

(97) EP3923914/ 12.04.2023

(96) 20704307.6/ 14.02.2020

(22) 24.04.2023

(21) AL/P/2023/162

(54) **FORMULIM I AFABICINËS, METODA PËR BËRJEN E SAJ**

16.08.2023

(30) 19157255

(71) Debiopharm International S.A.

Forum "après-demain" , Chemin Messidor 5-7

(72) CHABAUD, Sebastien;COLIN, Aude Anne-Laure;DECRETTE, Marie, 199 rue de la confrérie;267A rue de Rouly Résidence le Belvédère;Störklingasse 44

(74) Krenar LOLOCI

Rr. "Dëshmorët e 4 Shkurtit", Pall. 1/1, Kati 2, Tiranë

(57)

1. Kompozimi farmaceutik i ngurtë në formën e një doze njësi që përfshin Afabycin ose një kripë farmaceutikisht të pranueshme të tij dhe një ose më shumë eksipientë farmaceutikisht të pranueshëm, karakterizuar në atë që kompozimi përmban një përbërje histidine.

2. Kompozimi farmaceutik i ngurtë sipas pretendimit 1, i cili përfshin Afabycin ose një kripë farmaceutikisht të pranueshme të tij në një sasi prej nga 20 mg deri në 480 mg.

3. Kompozimi farmaceutik i ngurtë sipas pretendimit 1 ose 2, i cili përmban histidinë.

4. Kompozimi farmaceutik i ngurtë sipas çdonjërit prej pretendimeve 1 deri në 3, i cili është në formën e një tablete, tableta në mënyrë të preferuar që përfshin një fazë të brendshme dhe një fazë të jashtme, ku Afabycin ose një kripë farmaceutikisht e pranueshme e tij është në mënyrë të preferuar mbajtur vetëm në fazën e brendshme.

5. Kompozimi farmaceutik i ngurtë sipas pretendimit 4, i cili përmban përbërjen e histidinës vetëm në fazën e brendshme.

6. Kompozimi farmaceutik i ngurtë sipas çdonjërit prej pretendimeve 1 deri në 5, i cili përmban një lidhës të zgjedhur nga grupi i përbërë prej povidon, kopovidon, poloksamer, polietilen glikol, aluminosilikat magnezi, xhelatinë, akacia, dekstrinë, dekstrate, dekstrozë, polidekstrozë, gomë guar, vaj vegjetal të hidrogjenizuar, glukozë të lëngshme, dyll, maltozë, sukrozë, laktozë, dyll, dhe përzierje të tyre.

7. Kompozimi farmaceutik i ngurtë sipas çdonjërit prej pretendimeve 1 deri në 6, i cili përmban një hollues të zgjedhur nga grupi i përbërë prej manitol, isomalt, laktozë, fosfat

kalciumi, karbonat kalciumi, sulfat kalciumi, sukrozë, fruktozë, maltozë, ksilitol, maltitol, laktitol, trehalozë, silikat alumini, ciklodekstrinë, dekstrozë, polidekstrozë, glukozë, dekstrinë, dekstrate, karbonat magnezi dhe përzierje të tyre.

8. Kompozimi farmaceutik i ngurtë sipas çdonjërit prej pretendimeve 1 deri në 7, i cili përmban një surfaktant të zgjedhur nga grupi i përbërë prej lauril sulfat natriumi, poloksamere, dokusat natriumi, deoksikolat natriumi, estere sorbitani, estere sukroze të acidit yndyror, tiloksapol, lecitinë dhe polisorbat dhe përzierje të tyre.

9. Kompozimi farmaceutik i ngurtë sipas çdonjërit prej pretendimeve 1 deri në 8, i cili përmban një shpërbërës të zgjedhur nga grupi i përbërë prej krosopovidon, aluminosilikat magnezi, dioksid silikoni koloidal, gomë guar dhe përzierje të tyre.

10. Kompozimi farmaceutik i ngurtë sipas çdonjërit prej pretendimeve 1 deri në 3 dhe 6 deri në 9, i cili është në formën e një kapsule që përmban Afabicin ose një kripë farmaceutikisht të pranueshme të tij dhe një ose më shumë eksipientë farmaceutikisht të pranueshëm në formën e një pluhuri ose granulati.

11. Metoda e prodhimit të kompozimit të ngurtë sipas çdo njërit prej pretendimeve 1 deri në 9, i cili përfshin hapat e mëposhtëm në rendin e specifikuar:

- (i) përzierjen në të thatë të disa ose të gjithë përbërësve të kompozimit;
- (ii) granulimin e përzierjes rezultuese për të përfutur një granulat;
- (iii) shtimin e ndonjë komponenti të mbetur të kompozimit te granulati;
- (iv) kompresimi i përzierjes rezultuese për të përfutur një tabletë të kompresuar; dhe
- (v) opsionalisht veshjen e tabletës rezultuese të kompresuar.

12. Metoda sipas pretendimit 11, hapi i granulimit është kryer nga granulimi në të njomë ose granulimi në të thatë.

13. Metoda sipas pretendimit 11 ose 12, ku të paktën një prej gjendjeve të mëposhtme është plotësuar:

- (a) holluesi është i pranishëm dhe një pjesë e holluesit është shtuar te granulati i hapi (ii);
- (b) shpërbërësi është i pranishëm dhe një pjesë e shpërbërësit është shtuar te granulati i hapi (ii);
- (c) rrëshqitësi është i pranishëm dhe një pjesë e ose i gjithë rrëshqitësi është shtuar te granulati i hapi (ii); dhe/ose
- (d) lubrifikanti është i pranishëm dhe një pjesë e ose ose i gjithë lubrifikati është shtuar te granulati i hapi (ii).

14. Kompozimi farmaceutik i ngurtë sipas çdonjërit prej pretendimeve 1 deri në 10 për përdorim në një metodë të trajtimit të infeksionit bakterial në një gjitar.

15. Kompozimi farmaceutik i ngurtë për përdorim sipas pretendimit 14, ku gjitari është një njeri.

16. Kompozimi farmaceutik i ngurtë për përdorim sipas pikës 14 ose 15, ku infeksioni

bakterial është shkaktuar nga speciet bakteriale *S. aureus*, infeksione të tilla që janë p.sh. infeksion bakterial akut i lëkurës dhe i strukturës së lëkurës (ABSSI) ose infeksione bakteriale të lidhura me sindromën e këmbës diabetike.

(11) **11546**

(97) EP3840596/ 08.02.2023

(96) 19794142.0/ 23.10.2019

(22) 25.04.2023

(21) AL/P/2023/164

(54) **KOMPOZIMI**

17.08.2023

(30) 18202355,19175946

(71) Zanoprima Lifesciences Limited

31 Kentish Town Road Camden Town

(72) HYDE, Nicholas; JACKSON, William; MCCAGUE, Raymond; NARASIMHAN,

Ashok. S., C/O Zanoprima Lifesciences Limited 5th Floor, Charles House 108-110

Finchley Road; C/O Zanoprima Lifesciences Limited 5th Floor, Charles House 108-110

Finchley Road; C/O Zanoprima Lifesciences Limited 5th Floor, Charles House 108-110

Finchley Road; C/O Zanoprima Lifesciences Limited 5th Floor, Charles House 108-110

Finchley Road

(74) Krenar LOLOCI

Rr. "Dëshmorët e 4 Shkurtit", Pall. 1/1, Kati 2, Tiranë

(57) 1. Një kompozim inhalues, i përshtatshëm për t'u përdorur në një pajisje cigareje elektronike, që përfshin të paktën 1 g/L nikotinë dhe të paktën 2 g/L dioksid karboni të tretur ose të shpërndarë në një tretës që përfshin glicerol dhe ujë, ku raporti molar i dioksidit të karbonit ndaj nikotinës është të paktën 0.1:1;

ku glicerina është e pranishme në një sasi prej të paktën 40% ndaj peshës, bazuar në peshën totale të kompozimit inhalues;

ku uji është i pranishëm në një sasi prej 1-20% ndaj peshës, bazuar në peshën totale të kompozimit inhalues; dhe

ku propilenglikoli, kur është i pranishëm, është i pranishëm në një sasi prej jo më shumë se 10% ndaj peshës, bazuar në peshën totale të kompozimit inhalues.

2. Kompozimi i pretendimit 1, që përfshin 1-60 g/L nikotinë, në mënyrë të preferuar 5-60 g/L nikotinë.

3. Kompozimi i çdonjërit pretendim të mësipërm, që përfshin 2-40 g/L dioksid karboni.

4. Kompozimi i çdonjërit pretendim të mësipërm, ku raporti molar i dioksidit të karbonit ndaj nikotinës është në rangun nga 0.1:1 deri në 10:1, në mënyrë të preferuar 0.25 deri në 7.5:1, në mënyrë më të preferuar 0.4:1 deri në 5:1.

5. Kompozimi sipas pretendimit 1, ku propilenglikoli, kur është i pranishëm, është i pranishëm në një sasi prej jo më shumë se 5% ndaj peshës, bazuar në peshën totale të

kompozimit inhalues.

6. Kompozimi sipas pretendimit 1, ku tretësi përmban glicerinë në një sasi prej të paktën 50%, në mënyrë të preferuar të paktën 60%, në mënyrë më të preferuar të paktën 70% ndaj peshës bazuar në peshën totale të kompozimit inhalues.

7. Kompozimi sipas çdonjërit prej pretendimeve 1-6, ku uji është i pranishëm në një sasi prej 1-15% ndaj peshës, në mënyrë të preferuar 1-10% ndaj peshës, bazuar në peshën totale të kompozimit inhalues.

8. Kompozimi sipas çdonjërit pretendim të mësipërm, ku kompozimi përfshin më pak se 10 g/L tretës të ndezshëm si etanoli, në mënyrë të preferuar ku përbërja është e lirë nga tretës i ndezshëm si etanoli.

9. Kompozimi i çdonjërit pretendim të mëparshëm që përfshin më tej një ose më shumë përbërës aromatizues.

10. Një fishek i përshtatshëm për t'u përdorur me një pajisje cigareje elektronike, fishek në fjalë që përfshin kompozimin inhalues sipas çdonjërit prej pretendimeve 1-9.

11. Një pajisje cigareje elektronike që përfshin fishekun e pretendimit 10.

12. Një metodë për të bërë kompozimin inhalues sipas çdonjërit prej pretendimeve 1-9, që përfshin hapat e

shtimit e të paktën 1 g/L nikotinë në një tretës që përfshin glicerinë dhe ujë brenda një ene të mbyllur për të formuar një tretësirë ose dispersion të nikotinës; dhe futja e dioksidit të karbonit në enë në mënyrë që presioni brenda enës të jetë në rangun nga 1 deri në 15 atmosfera të matur në 20 °C, në mënyrë që të paktën 2 g/L dioksid karboni të shpërndahet ose të shpërndahet në tretës, dhe në mënyrë të tillë që raporti molar i dioksidit të karbonit ndaj nikotinës është të paktën 0.1:1; ku glicerina është e pranishme në një sasi prej të paktën 40% ndaj peshës, bazuar në peshën totale të kompozimit inhalues;

ku uji është i pranishëm në një sasi prej 1-20% ndaj peshës, bazuar në peshën totale të kompozimit inhalues; dhe

ku propilenglikoli, kur është i pranishëm, është i pranishëm në një sasi prej jo më shumë se 10% ndaj peshës, bazuar në peshën totale të kompozimit inhalues.

13. Një kompozim inhalues, i përshtatshëm për t'u përdorur në një pajisje cigareje elektronike, që përfshin të paktën 1 g/L nikotinë dhe të paktën 0.027 g/L dioksid karboni të tretur ose të shpërndarë në një tretës, ku raporti molar i dioksidit të karbonit ndaj nikotinës është të paktën 0.025:1, ku tretësi përfshin më së shumti 5% të vëllimit ujë në raport me vëllimin total të tretësit.

14. Kompozimi i pretendimit 13, që përfshin më tej 1-60 g/L nikotinë, në mënyrë të preferuar të paktën 3 g/L nikotinë, në mënyrë më të preferuar ku tretësi përfshin glicerinë, ose propilenglikol, ose ujë, ose përzierje të tyre.

15. Kompozimi i pretendimit 14, ku proporcioni i glicerolit ndaj propilenglikolit i pranishëm në tretës është në rangun nga 95:5 deri në 5:95 për vëllim, në mënyrë të preferuar 80:20 deri në 20:80 për vëllim, në mënyrë më të preferuar 70: 30 deri në 30:70 për vëllim.

16. Një metodë për të bërë kompozimin inhalues sipas çdonjërit prej pretendimeve 13-15, që përfshin hapat e

shtimit e të paktën 1 g/L nikotinë në një tretës brenda një enë të mbyllur për të formuar një tretësirë ose dispersion nikotine; dhe
futjen e dioksidit të karbonit në enë në mënyrë që presioni brenda enës të jetë në rangun nga 1 deri në 15 atmosfera të matur në 20 °C, në mënyrë që të paktën 0.027 g/L dioksid karboni të tretet ose të shpërndahet në tretës, dhe në mënyrë të tillë që raporti molar i dioksidit të karbonit ndaj nikotinës është të paktën 0.025:1.

(11) **11548**

(97) EP3927949/ 15.02.2023

(96) 19835510.9/ 17.12.2019

(22) 02.05.2023

(21) AL/P/2023/175

(54) **IMPIANT DHE PROCES I MAGAZINIMIT TË ENERGJISË**

17.08.2023

(30) 201900002385

(71) Energy Dome S.p.A.

Viale Abruzzi 94

(72) SPADACINI, Claudio, Via Troubetzkoy, 58

(74) Krenar LOLOCI

Rr. "Dëshmorët e 4 Shkurtit", Pall. 1/1, Kati 2, Tiranë

(57)

1. Impianti i magazinimit të energjisë, që përfshin:

një mbështjellje (5) që magazinon një lëng pune të ndryshëm nga ajri atmosferik, në një fazë të gaztë dhe në ekuilibër presioni me atmosferën, ku mbështjellja e përmendur (5) është një tullumbace presioni ose ka strukturën e një gazometri; një rezervuar (9) që magazinon lëngun e përmendur në fazë të lëngshme ose superkritike me një temperaturë afër temperaturës kritike; ku temperatura kritike e përmendur është afër temperaturës së ambientit; ku impianti është konfiguruar për të kryer një transformim termodinamik ciklik të mbyllur (TTC), fillimisht në një drejtim në një konfigurim ngarkese dhe më pas në një drejtim të kundërt në një konfigurim shkarkimi, midis mbështjelljes së përmendur (5) dhe rezervuarit të përmendur (9); ku në konfigurimin e ngarkesës impianti magazinon nxehtësinë dhe presionin dhe në konfigurimin e shkarkimit gjeneron energji.

2. Impianti sipas pretendimit 1, ku lëngu i punës ka vetitë kimike-fizike të mëposhtme: temperaturë kritike ndërmjet 0°C dhe 200°C, dendësi në 25°C ndërmjet 0,5 kg/m³ dhe 10 kg/m³; dhe/ose zgjidhet në grupin që përfshin: CO₂, SF₆, N₂O.

3. Impiant sipas pretendimit 1 ose 2, që përfshin:

- një kompresor (3) dhe një motor të lidhur mekanikisht me njëri-tjetrin; |
- një turbinë (2) dhe një gjenerator të lidhur mekanikisht me njëri-tjetrin;
- mbështjelljen e përmendur (5) është në kontakt nga jashtë me atmosferën dhe kufizohet brenda një vëllimi të konfiguruar që të përmbajë lëngun e punës në presion atmosferik ose presion thelbësisht atmosferik, ku vëllimi i përmendur është në mënyrë selektive në komunikim të lëngut me një hyrje (3a) të kompresorit (3) ose me një dalje (2b) të turbinës (2);
- një shkëmbyes primar nxehtësie (7) në mënyrë selektive në komunikimin e lëngjeve me një dalje (3b) të kompresorit (3) ose me një hyrje (2a) të turbinës (2);
- rezervuarin e përmendur (9) në komunikimin e lëngut me shkëmbyesin primar të nxehtësisë (7) për të grumbulluar lëngun e punës;
- një shkëmbyes sekondar nxehtësie (10) funksionalisht aktiv midis shkëmbyesit primar të nxehtësisë (7) dhe rezervuarit (9) ose në rezervuarin e përmendur (9);
impianti i përmendur duke u konfiguruar për të funksionuar në konfigurimin e ngarkimit ose në konfigurimin e shkarkimit;
ku, në konfigurimin e ngarkesës, mbështjellja (5) është në komunikim të lëngut me hyrjen (3a) të kompresorit (3) dhe shkëmbyesi primar i nxehtësisë (7) është në komunikim të lëngut me daljen (3b) të kompresorit (3), turbina (2) është në qetësi, motori është në punë dhe drejton kompresorin (3) për të ngjeshur lëngun e punës që vjen nga mbështjellja (5), shkëmbyesi primar i nxehtësisë (7) punon si ftohës për të hequr nxehtësinë nga lëngu i punës i ngjeshur, për ta ftohur dhe magazinuar energjinë termale, shkëmbyesi sekondar i nxehtësisë (10) punon si ftohës për të hequr nxehtësinë shtesë nga lëngu i punës i ngjeshur dhe për të magazinuar energjinë termale shtesë, rezervuari (9) merr dhe magazinon lëndën e ngjeshur dhe lëng pune i ftohur, ku lëngu i punës i magazinuar në rezervuar (9) ka një temperaturë afër temperaturës së tij kritike;
ku, në konfigurimin e shkarkimit, mbështjellja (5) është në komunikim të lëngut me daljen (2b) të turbinës (2) dhe shkëmbyesi primar i nxehtësisë (7) është në komunikim të lëngut me hyrjen (2a) të turbinës (2), kompresori (3) është në qetësi, shkëmbyesi sekondar i nxehtësisë (10) punon si ngrohës për të lëshuar nxehtësi në lëngun e punës që vjen nga rezervuari (9), shkëmbyesi primar i nxehtësisë (7) punon si ngrohës për të lëshuar nxehtësi të mëtijshme në lëngun e punës dhe për ta ngrohur atë, turbina (2) rrotullohet nga lëngu i ngrohur i punës dhe drejton gjeneratorin që gjeneron energji, lëngu i punës kthehet në mbështjellje (5) në presionin atmosferik ose thelbësisht atmosferik.

4. Impianti sipas pretendimit 3, që përfshin një shkëmbyes nxehtësie shtesë (13) të vendosur në mënyrë operative midis mbështjelljes (5) dhe kompresorit (3) dhe midis mbështjelljes (5) dhe turbinës (2) për të ngrohur paraprakisht lëngun e punës përpara ngjeshjes në kompresor (3), në konfigurimin e magazinimit, ose për të ftohur lëngun e punës nga turbina (2), në konfigurimin e shkarkimit.

5. Impiant sipas një prej pretendimeve 3 ose 4 të mëparshëm, ku motori dhe gjeneratori janë elementë të veçantë; ose ku motori dhe gjeneratori përcaktohen nga një motor-gjenerator i vetëm (4) dhe impianti përfshin pajisje lidhëse midis motor-gjeneratorit (4) dhe kompresorit (3) dhe turbinës (2) për të lidhur mekanikisht dhe në mënyrë alternative motor-

gjeneratori (4) te kompresori (3) ose te turbina (2).

6. Impiant sipas një prej pretendimeve të mëparshëm 3, 4 ose 5, ku shkëmbyesi sekondar i nxehtësisë (10) dhe shkëmbyesi primar i nxehtësisë (7) janë konfiguruar për të operuar një transformim super-kritik të lëngut të punës në mënyrë që lëngu i punës i përmendur të akumulohet në rezervuarin (9) në fazën superkritike.

7. Impiant sipas pretendimit të mëparshëm, ku rezervuari (9) përfshin një membranë ndarëse (31) të konfiguruar për të ndarë nga brenda rezervuarin (9) në një dhomë të parë me vëllim të ndryshueshëm (32) për lëngun e punës në fazën superkritike dhe në një dhomë e dytë me vëllim të ndryshueshëm (33) në komunikimin e lëngut me një qark kompensimi (34) që përmban një lëng jo të ngjeshshëm.

8. Impiant sipas njërit prej pretendimeve të mëparshëm nga 3 deri në 5, ku shkëmbyesi sekondar i nxehtësisë (10) dhe shkëmbyesi kryesor i nxehtësisë (7) janë konfiguruar për të operuar një transformim nënkritik të lëngut të punës në mënyrë që lëngu i punës të grumbullohet në rezervuari (9) në fazë të lëngshme.

9. Impiant sipas njërit prej pretendimeve të mëparshme 3 deri në 8, ku shkëmbyesi primar i nxehtësisë (7) është një rigjenerues nxehtësie i fiksuar ose i lëvizshëm ose përfshin një qark primar uji, vaji ose kripe (15) me të paktën një dhomë magazinimi primar (17, 18).

10. Impiant sipas njërit prej pretendimeve të mëparshëm nga 3 deri në 9, ku shkëmbyesi sekondar i nxehtësisë (10) përfshin një qark sekondar ajri ose uji (20) me të paktën një dhomë magazinimi dytësore (21, 22) dhe është konfiguruar për të hequr nxehtësinë nga lëngu i punës, në konfigurimin e ngarkesës, ose për të transferuar nxehtësinë në lëngun e punës, në konfigurimin e shkarkimit, në një temperaturë më të ulët se 100°C.

11. Proces për magazinimin e energjisë, që përfshin: kryerjen e një transformimi ciklik termodinamik të mbyllur (TTC), fillimisht në një drejtim në një konfigurim/fazë ngarkese dhe më pas në një drejtim të kundërt në një konfigurim/fazë shkarkimi, midis një mbështjelljeje (5) për magazinimin e një lëngu pune të ndryshëm nga ajri atmosferik, në një fazë të gaztë dhe në ekuilibër presioni me atmosferën, dhe një rezervuar (9) për magazinimin e lëngut të punës së përmendur në një fazë të lëngshme ose superkritike me një temperaturë afër temperaturës kritike; ku temperatura kritike të përmendur është afër temperaturës së ambientit; ku, në fazën e ngarkimit, procesi akumulon nxehtësi dhe presion dhe, në fazën e shkarkimit, gjeneron energji.

12. Procesi sipas pretendimit 11, ku faza e ngarkimit përfshin:

- ngjeshjen e lëngut punues të përmendur, që vjen nga mbështjellja e përmendur (5) nga jashtë në kontakt me atmosferën dhe kufizohet brenda një vëllimi të konfiguruar që të përmbajë lëngun e punës në presion atmosferik ose thelbësisht atmosferik, duke thithur energji;
- injektimin e lëngut të punës të ngjeshur përmes një shkëmbyesi primar nxehtësie (7) dhe një shkëmbyesi sekondar nxehtësie (10) të vendosur në seri për të afruar temperaturën e lëngut të punës me temperaturën e tij kritike; ku shkëmbyesi primar i nxehtësisë (7) punon si një ftohës për të hequr nxehtësinë nga lëngu i punës i ngjeshur, për ta ftohur atë dhe për të magazinuar energjinë termale, ku shkëmbyesi sekondar i nxehtësisë (10) punon si një ftohës për të hequr nxehtësinë e mëtejshme nga lëngu i punës i ngjeshur dhe magazinon më tej energji termale;
- akumulimin e lëngut të punës të ftohur në rezervuarin e përmendur (9); ku shkëmbyesi sekondar i nxehtësisë (10) dhe shkëmbyesi primar i nxehtësisë (7) kryejnë një transformim super-kritik të lëngut të punës në mënyrë që lëngu i punës i përmendur të grumbullohet në rezervuarin (9) në fazën superkritike ose ku

nxehtësia dytësore shkëmbyesi (10) dhe shkëmbyesi primar i nxehtësisë (7) kryejnë një transformim nënkritik të lëngut të punës në mënyrë që lëngu i punës i përmendur të grumbullohet në rezervuarin (9) në fazën e lëngshme; ku një temperaturë e lëngut të punës të akumuluar në rezervuar (9) është midis 0°C dhe 100°C dhe ku një presion i lëngut të punës të akumuluar në rezervuarin (9) është midis 10 bar dhe 150 bar.

13. Procesi sipas pretendimit 11 ose 12, ku lëngu i punës i përmendur ka vetitë fiziko-kimike të mëposhtme: temperaturë kritike midis 0°C dhe 200°C, dendësi në 25°C midis 0,5 kg/m³ dhe 10 kg/m³; dhe/ose zgjidhet në grup duke përfshirë: CO₂, SF₆, N₂O.

14. Procesi sipas pretendimit 12 ose 13, ku faza e shkarkimit dhe gjenerimit të energjisë përfshin:

- kalimin e lëngut të punës nga rezervuari (9) përmes shkëmbyesit sekondar të nxehtësisë (10) dhe shkëmbyesit primar të nxehtësisë (7); ku shkëmbyesi sekondar i nxehtësisë (10) punon si ngrohës për të transferuar nxehtësinë në lëngun e punës që vjen nga rezervuari (9), ku shkëmbyesi kryesor i nxehtësisë (7) punon si ngrohës për të transferuar nxehtësinë e mëtejshme në lëngun e punës dhe për ta ngrohur atë;
- kalimin e lëngut e nxehtë të punës përmes një turbine (2), ku turbina (2) rrotullohet nga lëngu punues i nxehtë dhe drejton gjeneratorin që gjeneron energji, ku lëngu i punës zgjerohet dhe ftohet në turbinë (2);
- ri-injektimin e lëngut të punës që vjen nga turbina (2) në mbështjellje (5) në presion atmosferik ose thelbësisht atmosferik.

15. Procesi sipas pretendimit 14, ku në fazën e shkarkimit dhe gjenerimit të energjisë, midis shkëmbyesit primar të nxehtësisë (7) dhe turbinës (2), sigurohet për të ngrohur më tej lëngun e punës nëpërmjet një burimi shtesë nxehtësie (230).

(11) **11544**

(97) EP3873894/ 22.03.2023

(96) 19800947.4/ 30.10.2019

(22) 02.05.2023

(21) AL/P/2023/177

(54) **KRIPA E RE E NJË FRENUESI BCL-2, FORMA KRISTALORE E LIDHUR ME TË, METODA PËR PËRGATITJEN E SAJ DHE KOMPOZIMET FARMACEUTIKE QË E PËRMBAJNË**

17.08.2023

(30) 18306430

(71) Vernalis (R&D) Limited

Granta Park

(72) LYNCH, Michael; MASSON, Ludovic; MOUCHET, Patrick; TAULELLE, Pascal; VILLARD, Frédéric, 533 Route de Lillebonne; 720 avenue de Fontainebleau; 74, rue des Chaises; 95 rue Lesueur; 97 Impasse du Bel Évent

(74) Krenar LOLOÇI

Rr. Ibrahim Rugova, P.1/1, Kati II, Tiranë, Shqipëri

(57)

1. Kripa hidrogjen sulfat e 5-(5-kloro-2-[[[(3S)-3-(morfolin-4-ilmetil)-3,4-dihidroisokinolin-2(1H-il)]karbonil} fenil]-N-(5-ciano-1,2-dimetil-1H-pirrol-3-il)-N-(4-

hidroksifenil)-1,2-dimetil-1*H*-pirrole-3-karboksamide (Përbërja A, H₂SO₄).

2. Një formë kristalore I e kripës hidrogjen sulfat e 5-(5-kloro-2-[(3*S*)-3-(morfolin-4-ilmetil)-3,4-dihidroisokinolin-2(1*H*)-il]karbonil} fenil)-*N*-(5-ciano-1,2-dimetil-1*H*-pirrol-3-il)-*N*-(4-hidroksifenil)-1,2-dimetil-1*H*-pirrole-3-karboksamide (Përbërja A, H₂SO₄) sipas pretendimit 1, ku forma kristalore ka një diagramë të difraksionit të pluhurit me rreze X që tregon vijat e mëposhtme të difraksionit (këndi i Bragg 2 theta, i shprehur në gradë $\pm 0.2^\circ$): 5.55 ; 6.62 dhe 7.39.

3. Një formë kristalore I e kripës hidrogjen sulfat e 5-(5-kloro-2-[(3*S*)-3-(morfolin-4-ilmetil)-3,4-dihidroisokinolin-2(1*H*)-il]karbonil} fenil)-*N*-(5-ciano-1,2-dimetil-1*H*-pirrol-3-il)-*N*-(4-hidroksifenil)-1,2-dimetil-1*H*-pirrole-3-karboksamide (Përbërja A, H₂SO₄) sipas pretendimit 1, ku forma kristalore ka një diagramë të difraksionit të pluhurit me rreze X që tregon të paktën 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14 ose të gjitha vijat e mëposhtme të difraksionit (këndi i Bragg 2 theta, i shprehur në gradë $\pm 0.2^\circ$): 5.55; 5.62; 6.62; 7.39; 10.17; 11.49; 11.83; 16.01; 16.54; 17.04; 18.98; 19.18; 21.90; 22.28; 24.89.

4. Forma kristalore I e kripës hidrogjen sulfat të Përbërjes A sipas pretendimit 3, karakterizuar në atë që ajo ka një diagramë të difraksionit të pluhurit me rreze X që ka vijat e mëposhtme të difraksionit (këndi i Bragg 2 theta, i shprehur në gradë $\pm 0.2^\circ$): 5.55; 5.62; 6.62; 7.39; 10.17; 11.49; 11.83; 16.01; 16.54; 17.04; 18.98; 19.18; 21.90; 22.28; 24.89.

5. Forma kristalore I e kripës hidrogjen sulfat të Përbërjes A sipas pretendimit 4, karakterizuar në atë që ajo ka diagramin e mëposhtëm të difraksionit të pluhurit me rreze X, të matur duke përdorur një difraktometër PANalytical X'Pert Pro MPD me një detektor X'Celerator dhe të shprehur në termat e pozicionit të vijës (këndi i Bragg 2 theta, i shprehur në gradë $\pm 0.2^\circ$) dhe distancat interplanare *d* (të shprehura në Å):

Li	Nr i	Këndi 2-theta (gradë)	Distanca interplanare
1		5.55	15.93
2		5.62	15.73
3		6.62	13.36

(vazhduar)

L_i	Nr i	Këndi 2-theta (gradë)	Distanca interplanare
4		7.39	11.95
5		10.17	8.70
6		11.49	7.70
7		11.83	7.48
8		16.01	5.53
9		16.54	5.36
10		17.04	5.20
11		18.98	4.67
12		19.18	4.63
13		21.90	4.06
14		22.28	3.99
15		24.89	3.58

6. Forma kristalore I e kripës hidrogjen sulfat të Përbërjes A sipas çdo njërit prej pretendimeve 1 deri në 5, karakterizuar në atë që ajo ka një spektër ¹³C CP/MAS NMR të gjendjes së ngurtë që ka majat e mëposhtme (të shprehura në ppm ± 0.2 ppm): 173.31 ppm, 155.32 ppm, 140.46 ppm, 139.19 ppm, 137.42 ppm, 134.68 ppm, 131.65 ppm, 131.14 ppm, 129.37 ppm, 126.32 ppm, 118.77 ppm, 117.36 ppm, 116.54 ppm, 113.61 ppm, 112.69 ppm, 110.74 ppm, 102.33 ppm, 101.45 ppm, 63.06 ppm, 57.19 ppm, 54.87 ppm, 52.06 ppm, 44.71 ppm, 43.94 ppm, 34.42 ppm, 32.89 ppm, 31.28 ppm, 30.66 ppm, 14.40 ppm, 13.34 ppm, 12.49 ppm dhe 10.50 ppm.

7. Kompozimi farmaceutik që përfshin si princip aktiv kripën hidrogjen sulfat të Përbërjes A sipas pretendimit 1 në lidhje me një ose më shumë eksipientë farmaceutikisht aktiv.

8. Kompozimi farmaceutik që përfshin si princip aktiv formën kristalore I të kripës hidrogjen sulfat të Përbërjes A sipas çdo njërit prej pretendimeve 2 deri në 6 në lidhje me një ose më shumë eksipientë farmaceutikisht aktiv.

9. Kompozimi farmaceutik sipas pretendimit 7 ose 8 për përdorim në trajtimin e kancereve, sëmundjeve auto-immune dhe sëmundjeve të sistemit imun.

